



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V. MINISTRI I TURIZMIT
TURIZMI TRAJTOHEM
Nr. 7128/3 Prot.
Datë 29.12.2015

V E N D I M

Nr. 1055, datë 23.12.2015

P Ë R

**MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR INSTRUMENTET
MATËSE”, NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1351,
DATË 3.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN
E RREGULLORES PËR KËRKESAT TEKNIKE
DHE METROLOGJIKE, PËR INSTRUMENTET MATËSE,
LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA”, DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS
SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 17, 5, pika 2, 6 dhe 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, dhe pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për instrumentet matëse”, sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.
2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të instrumenteve, referuar në pikën 1, sipas listës bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.
3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të instrumenteve,

referuar në pikën 1, me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik të këtij vendimi.

4. Në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në pjesën II, “Matësit materialë të gjatësisë”, shfuqizohen pjesët: “Përkufizime”, “Kërkesa teknike metrologjike” dhe “Vendosja në treg”;
- b) Në pjesën III, “Masat e kapacitetit të shërbimit dhe masat vëllimore”, shfuqizohen dispozitat për masat e kapacitetit të shërbimit;
- c) Në pjesën IV, “Kontatorët e taksive (Taksimetrat)”, shfuqizohen pjesët: “Përkufizime dhe përcaktime”, “Kërkesa teknike-metrologjike”, “Kërkesa të tjera” dhe “Vendosja në treg”;
- ç) Në pjesën V, “Sistemet e matjes së sasive të lëngjeve, përveç ujit”, shfuqizohen pjesët: “Përkufizime-përcaktime”, “Kërkesat teknike-metrologjike”, dhe “Vendosja në treg”.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT.5649/1
DATË 22.12.2015

MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË ENERGIJË DHE INDUSTRIJË
MINISTRISË SË INTEGRIMIT EVROPIAN
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

